



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË  
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

Nisur nga konstatimi i disa shkeljeve, në përdorimin e pajisjeve elektronike, duke shfaqur pamje (foto/video) nga seancat gjyqësore, nga ana e gazetarëve, në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale, Vendimin Nr.716, datë 06.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e udhëzuesit standart të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe mediat”, Udhëzimin Nr. 9, datë 15.09.2010 të Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”, ju bëjmë më dije sa më poshtë:

**Udhëzuesi standart i marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe mediat, i miratuar me Vendimin Nr.716, datë 06.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor:**

Në Kapitullin IV, neni 13, pika 1 dhe 4 parashikon se:

1. **Seancat gjyqësore publike** janë të hapura për publikun dhe median.
4. Përfaqësuesi i medias, gjatë seancës, lejohet të raportojë përmes mesazheve të shkruara **nga pajisje telefonike dhe/ose kompjuterike, vetëm pasi më parë ka marrë autorizimin e kryetarit të seancës.** Në çdo rast, këto pajisje duhet të përdoren pa zë,

Në Kapitullin IV, neni 14, pika 1, 2 dhe 8 parashikon se:

1. Seancat gjyqësore mund të regjistrohen dhe transmetohen në media, me kërkesë të mediave ose me nismën e gjyqtarit/kryesuesit të trupit gjykues. **Në çdo rast, regjistrimi dhe transmetimi i seancës, tërësisht ose pjesërisht, bëhet vetëm kur nuk bie ndesh me rregullat e procesit të rregullt ligjor.**
2. Media elektronike mund të regjistrojë dhe transmetojë, tërësisht ose pjesërisht, **me urdhër të gjyqtarit/kryesuesit të trupit gjykues,** i cili vendos për çështjen objekt gjykimi. **Çdo regjistrim tjetër është i ndaluar.**
8. Kërkesa mund të refuzohet vetëm për këto arsye:
  - a) Seanca gjyqësore zhvillohet **me dyer të mbyllura;**
  - b) **Kur një nga subjektet në gjykim nuk dëshiron të regjistrohet seanca.** Ky rregull nuk vlen për prokurorin dhe avokatin.
  - c) **Çmohet nga gjyqtari/kryesuesi i trupit gjykues se prania e kamerave ndikon ecurinë e procesit të rregullt gjyqësor.**

**Udhëzimi Nr. 9, datë 15.09.2010, i Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”:**

Në Kreun I, pika 8 dhe 10 parashikon se:

**8. ... gazetari nuk merr as prodhon imazhe dhe fotografi të njerëzve në gjendje arresti pa pëlqimin e tyre. Personat nuk duhen filmuar me hekura dhe pranga në duar.**

**10. Gazetarët ... po ashtu nuk mund të marrin imazhe në spital apo burg me kamera pa pëlqimin e subjekteve.**

Nga pamjet e sigurisë të instaluara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është konstatuar shkelja e ligjeve dhe udhëzimeve të mësipërme. Disa prej gazetarëve kanë shpërndarë foto dhe pamje filmike nga seancat gjyqësore, që po zhvilloheshin në ambjentet e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht në seanca të “Marrjes në pyetje të personave të arrestuar dhe verifikimin e kushteve dhe nevojave të sigurimit për personat nën hetim”, seanca këto të cilat zhvillohen **vetëm në prezencë të palëve, pa praninë e mediave dhe publikut, duke shkelur kështu rëndë garancitë dhe të drejtat që ligji procedural penal ju ofron personave nën hetim.**

**THEKSOJMË SE:** Nga ana e gjykatës, nëpërmjet kamerave të sigurisë, po kryhen verifikimet përkatëse për të evidentuar personat, **që në mënyrë të paligjshme dhe të përsëritur** kanë shkelur aktet e mësipërme, me qëllim marrjen e të gjitha masave për të parandaluar përsëritjen e veprimeve të tilla.

Tiranë, më datë 23.10.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar